



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE



Nr. 2088 / prot.
2

Tiranë, më 18 / 4 / 2019

VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT

Nr. 15 / 1, datë 18 . 4 . 2019

PËR

MIRATIMIN E VENDIMIT NR. 21, DATË 26.12.2018 “ PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT DHE LOGOS SË SHOQËRISË “ SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT- FAF” SHA

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Vendimit Nr. 570, datë 3.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore” dhe Statutit të shoqërisë, me cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “FAF” sha Tiranë, pasi shqyrtova vendimin e marrë nga Këshilli Mbikëqyrës;

VENDOSA

1. Miratimin e Vendimit Nr. 21, datë 26.12.2018 të Këshillit Mbikëqyrës “ Për miratimin e ndryshimit të emrit dhe logos së shoqërisë “ Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit-FAF”sha Tiranë.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “ FAF” sha Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT FAF SH.A

KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM


Nr 21 datë 26/12/2018


PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT DHE LOGOS SË SHOQËRISË
"SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT - FAF SH.A."


Në zbatim të nenit 154, dhe nenit 167 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), në mbështetje të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Shoqërisë së Parë Financiare të Zhvillimit FAF sh.a, Këshilli Mbikqyrës


VENDOSI:


1. Miratimin e ndryshimit të emrit të Shoqërisë nga "Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF" sh.a, në "Agrokredit.sha".
2. Miratimin e ndryshimit të Logos së shoqërisë, duke miratuar logon e re bashkëngjitur këtij vendimi.(Aneksi 1).
3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Z.Elton Haxhi
Kryetar


Znj. Besa Sháhini
Anëtar


Z.Parid Shkurti
Anëtar


Z. Petro Koci
Anëtar


Z.Valbona Shujaku
Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE



Nr. 6998 Prot.

Tiranë, më 18.4.2019

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Nr. 24 Datë 18 / 4 /2019

PËR

EMËRIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare”, i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 570, datë 03.10.2018 “ Për Këshillat Mbiqëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit” sha Tiranë;


VENDOSA

1. Emërimin në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbiqëqyrës në “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit” sha Tiranë.

- Znj. Saida Turabi
2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar“ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 3745 Prot.

Tiranë, më 18.4.2019

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 26 Datë 18.4.2019

PËR

**ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “SHOQËRIA E PARË FINANCIARE
E ZHVILLIMIT” FAF SHA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme Nr. 116, datë 18.9.2018 “Për miratimin e vendimit Nr.11, datë 31.8.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “ FAF ” Për miratimin e pasqyrave financiare, raportit të aktivitetit për vitin 2017 dhe destinimin e fitimit”, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “FAF” sha Tiranë;

VENDOSA:

1. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 47,800,000 lekë, i barabartë me 47,800 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 1,192,600,000 lekë, i barabartë me 1,192,600 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ngarkohet Drejtoria e shoqërisë “FAF” sh.a Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë



MINISTËR

Anila Denaj